

## **DEKLARATE SENSIBILIZUESE E REKTORATIT TE UNIVERSITETIT POLITEKNIK TE TIRANES**

### **"PERMIRESIMII CILESISE NE AKTIVITETET E UPT, DOMOSDOSHMERI E KOHES"**

Rektorati i UPT, ne mbledhjen e tij te dates .17.02.2009, pas trajtimit te problemit te cilesise ne UPT ne disa mbledhje te tij te muajit dhjetor 2008 dhe janar 2009, miratoi kete deklarate sensibilizuese drejtuar gjithe personelit te ketij Institucioni te Arsimit te Larte.

Universiteti Politeknik i Tiranes eshte nder universitetet me te vjeter dhe me me tradita ne Republiken e Shqiperise. Gjate nje periudhe pothuaj 60 vjecare ai gradualisht eshte zhvilluar dhe aktualisht eshte kthyer ne nje institucion te fuqishem dhe nder universitetet kryesore publike te vendit. Sot ne UPT zhvillojne aktivitetet e tyre mesimdhene, kerkimore shkencore dhe sherbimet per te tretet gjashte fakultete dhe dy institute kerkimore. Numri i studenteve qe studiojne ne UPT ka arritur ne rreth 8000, te shperndare ne 17 programe studimi me diploma DNP dhe 17 programe studimi me diploma DND. Prane UPT ndjekin studimet DNT, drejt marrjes se diplomes "Doktor", nje numer i konsiderueshem kandidatsh. Mesimdhenea ne UPT realizohet nga nje staf akademik, i brendshem dhe i jashtem, qe tani ka arritur ne rreth 750 profesore, asistent profesore, doktore, pedagoge, asistente pedagoge. Fakultetet dhe dy institutet, krahas mesimdhenes dhe kerkimit shkencor, i ofrojne ekonomise shqiptare edhe mjaft sherbime te rendesishme.

UPT, per vitin 2008, ka siguruar, ne total, rreth 893 mln leke nga buxheti dhe te ardhurat, nderkohe qe ka realizuar si shpenzime te pergjithshme nje shume prej 801 mln lekesh (se bashku me shpenzimet per projektet e kerkim zhvillimit.

Krahas ketij zhvillimi te pergjithshem sasior, ne UPT eshte investuar edhe per te permiresuar cilesine e punes komplekse per pergatitjen e specialisteve te larte dhe shkencetareve te rinj. Vecanerisht investime te perhereshme jane bere per cilesine e aktivitetit mesimdhene. Por, per arsye te ndryshme, objektive dhe subjektive, te gjithe ne, punonjesit e UPT,

e dime se ekziston nje disnivel ndermjet anes sasiore te aktiviteteve te kryera ne kete institution dhe anes cilesore te ketyre aktiviteteve.

Grumbullimi i mjaft, problemeve, nje pjese e te cileve u permenden me lart, kerkojne, ne periudhen e tanishme, trajtimin paresor, me efektivitet dhe eficence te cilesise ne UPT, ne menyre qe ky institution t'i pergjigjet gjithmone e me mire kerkesave ne rritje te paleve te interesuara per aktivitetet e tij: ne radhe te pare kerkesave te studenteve dhe familjeve te tyre, te ndermarrjeve industriale dhe institucioneve kerkimore dhe te sherbimit, si dhe te gjithe shoqerise ne pergjithesi.

Pervec nevojave te brendshme, nje "presion" jo te vogel, ne forma te ndryshme, ne kete drejtim ben dhe Arsimi i Larte Politeknik Europian: nepermjet kontakteve te drejtuesve tane me homologet e universiteteve europiane, nepermjet kontakteve dhe specializimeve te stafeve tona akademike prane ketyre universiteteve, nepermjet kerkesave per njohje ose ekuivalentim reciprok te njohurive apo diplomave, etj.

Shteti, si nje nga palet kryesore te interesuara per zhvillimin sasior dhe cilesor te Arsimit te Larte, nepermjet legjislacionit te Arsimit te Larte (ligji dhe aktet nenligjore qe e mbeshtetin ate) po synon tani qe te intensifikoje perpjekjet e institucioneve te Arsimit te Larte per te permiresuar edhe anen cilesore ne aktivitetet e tyre.

Ligji "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise", Nr. 9741, Dt 21.05.2007, e shpreh qarte theksin e madh qe i vihet problemit te cilesise dhe te sigurimit te saj ne institucionet e Arsimit te Larte qe ne Nenin 1 te tij te emertuar "Qellimi i ligjit":

"Ky ligj ka per qellim. te rregulloje aspekte te sigurimit te cilesise ne institucionet e Arsimit te Larte ne perputhje me standardet evropiane ."

Po ashtu ne kete Ligj, ne Nenin 90 shpallet se:

"Institucionet e Arsimit te Larte, te diet jane krijuar para hyrjes ne fuqi te ketij ligji duhet t'i nenshtrohen procesit te vleresimit dhe akreditimit sipas ketij ligji brenda tre vjeteve nga hyrja ne fuqi e tij"

Ne Ligjin "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise", Nr. 9741, Dt 21.05.2007, problemeve te cilesise, te sigurimit te cilesise, te vleresimit te brendshem dhe te vleresimit te jashtem si dhe te akreditimit u eshte lene vend ne mbi 18 nene, nga me te rendesishmit e Ligjit.

Nga ana tjeter, ne UPT ekzistojne mundesi jo te vogla, te cilat lejojne ndermarrjen e veprimeve jo vetem taktike por dhe strategjike ne drejtim te permiresimit te cilesise. Nder keto mundesi mund te permenden:

- Vete permbajtja e Ligjit "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise", Nr. 9741, Dt 21.05.2007 si dhe e nje numri aktesh nenligjore (Vendime te Keshillit te Ministrave, Urdhera dhe udhezime te Ministrit dhe MASH-it), qe jane nxjerre mbi bazen e tij. Te gjitha keto materiale jane te mbushur me standarde te ndryshme qe udhezojne trajtimin e cilesise ne UPT.
- Statuti dhe Rregullorja e UPT, rregulloret e fakulteteve, etj., qe jane dokumente shume te rendesishme ku mund dhe duhet bazuar per trajtimin e permiresimeve cilesore ne UPT.
- Krijimi i nje "terreni" dhe nje "ambienti" qe i mirepret perpjekjet per te trajtuar dhe zgjidhur gradualisht problemin e rritjes se cilesise ne UPT.
- Niveli i larte aktual i arritur i kualifikimit te stafit akademik.
- Pervoja dhjetra-vjecare e grumbulluar ne pergjithesi dhe sidomos ajo e ketyre 10-15 viteve te fundit ne drejtim te trajtimit te cilesise, mesimdhënies dhe rritjes se nivelit te cilesise se saj, pergatitja e dokumentacioneve te sistemeve te cilesise, vleresimi i brendshem dhe i jashtem i cilesise ne disa programe studimi, etj, ne kuadrin e projekteve "Tempus".
- Mbeshtetja financiare e Ligjit "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise", Neni 73 "Burimet e Financimit te Institucioneve publike te Arsimit te Larte" i cili garanton se:
  - " Keshilli i Ministrave, permes MASH u jep institucioneve publike te Arsimit te Larte fonde per permbushjen e misionit te tyre sipas standardeve...."

**Si i pergjigjet UPT sfides se sotme te cilesise ne aktivitetet e tij?**

Ne mbledhjen e Rektoratit, date 22.12.2008, pas trajtimit dhe analizes se kujdesshme te cilesise, sidomos ne drejtim te mesimdhenies (programeve te studimit) u pranua njezori se trajtimi i cilesise ne UPT eshte nje domosdoshmeri urgjente, te cilen duhet ta evidentojme me shume kujdes dhe ta trajtojme me efektivitet dhe eficence.

Po ne kete mbledhje Rektorati mori keto vendime te rendesishme, ne lidhje me cilesine ne kete Institucion:

- Te ngrihet Qendra e Sigurimit te Cilesise e UPT-se".
- Te ndermerret Programi 3 vjecar "Permirosimit i cilesise ne aktivitetet e UPT".

Muajt shkurt dhe mars 2009 te jene muajt e sensibilizimit gjithperfshires te personelit (ne te gjitha nivelet hierarkike administrative) dhe te studenteve te UPT per problemin e permiresimit te cilesise ne UPT.

Me kete rast rektorati i UPT ju drejtohet te gjithe, pedagogeve, punonjesve dhe studenteve te mbeshtesin dhe te marrin pjese gjallerisht ne procesin e sensibilizimit per problemin e cilesise ne te gjitha aktivitetet qe zhvillohen ne kete institucion, duke bere te tyre parullen:

**"Drejt standardeve europiane te cilesise ne UPT"**

**Rektori i UPT**

**Akademik Jorgaq KACANI**

Tirane, 17.02.2009